



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Komuna e Malishevës
Municipality of Malisevo
Drejtoria për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë



Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Datë 17/01/2024

PRANUAR MË: 17-01-2024
ACCEPTED ON: 17-01-2024
PRIMLJENO:
06 Jan
Nr. No. Gr.

Për: Kryetarin e Komunës së Malishevës - Ekrem Kastrati

Nga: Drejtori – Bashkim Krasniqi

PLANI I PUNËS Janar - Dhjetor 2024

Malishevë

1. HYRJE

Plani vjetor i punës në mënyrë të përgjithshme përcakton veprimet të cilat duhet të ndermerren për t'i arritur synimet dhe objektivat strategjike të Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë. Ky plan është hartuar duke u bazuar në objektivat e përcaktuara nga sektorët që operojnë në kuadër të drejtorisë, nevojat në avansimin e sherbimeve dhe procedurave si dhe praktika e më hershme.

Realizimi i këtyre objektivave duhet të bëhet në harmoni me dispozitat ligjore, udhëzimet administrative dhe rregulloret të cilat përcaktojnë procedurat e punës së kësaj drejtorie. Ky plan i punës ka për qëllim arritjen e rezultateve të duhura, rritjen e numrit të kërkesave rritjen e të hyrave duke mbrojtur interesin e palëve dhe interesin e përgjithshëm, duke zhvilluar bashkëpunim të ngushtë më të gjitha palët e interesit si dhe duke siguruar një mjesid të mirë të punës, trajtim të barabartë dhe mundësi për zhvillim profesional dhe përparim në karrierë të gjithë të punësuarve në këtë drejtori.

2. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E DREJTORISË PËR GJEODEZI KADASTËR DHE PRONË

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, bazuar në Ligji Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrat të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligjit Nr.2003/13 mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligji Nr. 2002/5 mbi Themelimin e Regjistrat të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligji Nr. 04/L-009 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligji Nr. 2002/5 mbi Themelimin e Regjistrat të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligji nr. 04/I-013 për Kadastër, Ligji Nr.2002/4 për Hipotekat, si dhe aktet nënligjore në kuader të këtyre ligjeve, ka për detyrë sipas akteve të ndryshme si p.sh vendimeve gjyqësore, vendimeve administrative, kontratake, të bëjë regjistrimet apo ndryshime në regjistra kadastral, po ashtu sipas kërkesës së palëve dhe gjeodeteve të licencuar të bëjë ndarje, bashkim parcelash, e matje të ndryshme.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive që ka kjo drejtori kryen edhe këto punë: azhurnimi i pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja, ndarja e ngastrave dhe shënimë i kufijve në rastin e shpronësimit, kryen procedurat rrëth shpronësimit të tokës, zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyriare dhe zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës se palëve, bënë korrigjimin e regjistrat lidhur me regjistrimin e pronës sipas ligjeve ne fuqi, regjistrimin e hipotekës, regjistrimin e servituteve, regjistrimin e pronës dhe objekteve, regjistrimin e pronës së dhënë në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, lëshon certifikata të pronësisë, kopje plani, mbron pronën komunale-publike nga uzurpimet dhe udhëheqë procedurat lidhur me këtë çështje.

Kjo drejtori kryen edhe punë të tjera shtesë varësisht nga kërkesat e organeve më të larta apo nevojat imediate që mund të paraqiten.

3. SEKTORËT E DREJTORISË

Në kuadër të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, puna dhe procedurat janë të shpërndara në tre sektor: sektori i kadastrit, sektori i gjeodezisë dhe sektori i pronës.

Sektori i Kadastrit – ky sektor bënë pranimin e lëndëve të cilat kanë të bëjnë me regjistrime dhe ndryshime në regjistra kadastrale të cilat bëhen në bazë të akteve të ndryshme juridike, vendimeve gjyqësore, vendimeve administrative apo kontratave të ndryshme, regjistrimi i hipotekave, servituteve, objekteve, etj. Për secilin shërbim me udhëzime administrative dhe rregullore janë të parapara tarifat për këto shërbime. Pasi zyrtarët e kadastrit pranojnë lëndën, e njëjta shqyrtohet nëse është e pakompletuar atëherë me aktvendim pezullohet dhe njoftohet pala për plotësim lende dhe pas plotësimit merret vendimi për aprovim, për ndryshimet e nevojshme në regjistra. Po ashtu ky sektor lëshon dokumente të ndryshme kadastrale si certifikata të pronës, certifikatë që nuk posedon pasuri të paluajtshme.

Sektori i Gjeodezisë - është sektori ku palët kanë mundësi që ta shohin gjendjen e pronave të tyre në pjesën grafike, të bëjnë kërkesa të ndryshme për regjistrimin e ndarjeve, bashkimin e parcelave, matje të ndryshme, korrigjime, barazime të pjesës grafike me pjesën tekstuale, paisijen me kopje plani, etj. Po ashtu ky sektor realizon bashkëpunime me drejtori tjera aty ku paraqitet nevoja që të bëhen incizime dhe konstatime ne terren.

Sektori i Pronës - sektori i pronës zhvillon procedura të ndryshme që kanë të bëjnë me usurpime të pronës komunale, pranon kërkesa nga përfaqësues të fshatrave që kanë te bëjnë me hapjen e ndonjë rrugë nëpër prona private dhe regjistrimin e saj në kadastër, zhvillon procedura për këmbimin e pronës publike me pronë private sipas vendimeve administrative, pranon kërkesa dhe jep kopje të lëndëve të vjetra të cilat janë të arkivuara në këtë sektor si dhe punë të tjera shtesë.

4. OBJEKTIVAT DHE VEPRIMET

Nr	Përshkrimi i objektivave	Periudha kohore	Procedurat dhe aktivitetet në realizimin e objektivave	Sektori implementues
1.	Zhvillimi i procedurave administrative per modifikim dhe plotësim të regjistrave kadastral me të dhënat që mungojnë si, tipi i pronës, numri personal i pronarit, lloji i shfrytëzimit, kultura apo atribute tjera, procedura që do të zhvillohen sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve.	Janar - Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> ➢ Identifikimi i rasteve; ➢ Përgatitja e dokumentacionit kadastral mbi bazen e të cilave do të bëhet plotësimi i të dhënave; ➢ Verifikimi i dokumentacionit të gjendjes civile. 	Sektori i kadastrës Sektori gjeodezisë Sektori pronës
2.	Implementimi në regjistrat kadastral sipas Vendimit Përfundimtar Nr.03/197 datës 25.09.2014 të Qeverisë së Republikës se Kosovës ne kuadër të shpronësit te sipërfaqeve për shtyllat e linjes 400kV projekti i KOSTT-it, në zonat kadastrale Balincë, Vermircë, Shkarashnik, Drenoc, Carrallukë, Mirushë, Dragobil, Burim dhe Gurbardhë në Komunën e Malishevës.	Janar - Prill	<ul style="list-style-type: none"> ➢ Kërkesa drejtuar KOSTT-it, për të dorzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshem për regjistrimin e shpronësimeve; ➢ Ndarjet në pjesën grafike dhe përgatitja e regjistrave për futjen e të dhenave në sistem; ➢ Përgatitja e lëndëve për ndryshimet e nevojshme në pjesën tekstuale; ➢ Dorëzimi i një kopje të lëndës më të gjitha dokumentet përcjellëse për shpronësim në shërbimin pronësor. 	Të tre sektorët e kësaj drejtorie
3.	Regjistrimi i vendimeve të vjetra për ekspropojim të pronës në rrugët regionale Malishevë-Kijevë, Malishevë – Arllat, Malishevë – Rahovec dhe Malishevë - Bllacë, aty ku nuk janë bërë ndryshimet sipas lendëve dhe regjistrave për zgjerimin e rrugëve.	Janar – Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> ➢ Gjetja e lëndëve të vjetra për ekspropojim të pronave; ➢ Futja e të dhenave në regjistrat kadastral ➢ Kërkesa në institucione të ndryshme, Ministrinë e Infrastruktures, Arkiven Qëndrore të Kosovës, për plotësim dokumentacioni. 	Të tre sektorët
4.	Përgatitja e lëndëve të cilat janë në shqyrtim në Asamble Komunale, dhe zhvillimi i procedurave lidhur me çështjet pronësore si: <ul style="list-style-type: none"> - Dhënia e pronës në shfrytëzim; - Këmbimi i pronës komunale me pronën private; - Parcializimin e pronës për ndonjë interes të përgjithshëm; - Përgatitja e lëndëve për shpronësim, etj. 	Janar – Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> ➢ Përgatitja e regjistrave për ndarjen e parcelave ➢ Dhënia e informacioneve të duhura për pronaret që janë pjesë e këmbimit ➢ Informimi rreth akteve të velërësimit ➢ Nxjerra e dokumentacionit kadastrale, certifikatë të pronës, kopje plani; ➢ Dalja dhe inqizimi i terrenit në rastet kur kjo është e nevojshme. 	Të tre sektorët e kësaj drejtorie

5.	Identifikimi i usurpimeve të pronës publike komunale, që hynë nën kompetencën e Komunës së Malishevës Zhvillimi i procedurave administrative për usurpim Përgatitja e lëndëve për ekzekutim dhe lirim të pronës publike; Përgatitja e lëndëve për gjykatë.	Janar – Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Analizimi dhe rifreskimi i listave të pronave të usurpuara; ➤ Konstatimi i gjendjes faktike nga ana e gjeodetëve; ➤ Bashkëpunimi me Inspektorët komunal lidhur me veprimet e përbashkëta për lirim të pronës komunale. 	Sektori i Pronës Gjeodezisë Kadastrës
6.	Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për matje, ingjizim, kërkesa për rilevim të pronave e rrugëve publike, Kërkesa nga Kryetari, Drejtoria e Urbanizimit, Drejtoria e Inspektoratit, institucionet tjera, policia, gjykata, bashkësítë lokale, etj.	Janar – Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikimi i ngastrave; ➤ Verifikimi i dokumentacioneve të vjetra; ➤ Krahasimi i ndryshimeve; ➤ Incizimi i rrugëve; ➤ Informata për gjendjen grafike. 	Gjeodezia Kadastra
7.	Puna në RDPP, shqyrtimi i të gjitha kërkesave që kanë të bëjnë me regjistrim të kontratave përbartje, dhurim të pronave, kontratave përbashkëinvestim, regjistrimi i hipotekave, barrave tatimore, vendimeve gjyqësore, regjistrimi i shënimëve të përmbarimit, regjistrimi i ndarjeve dhe bashkimit të parcelave, servituteve, etj	Janar – Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Analizimi i lëndëve, dokumentacioneve përcjellëse dhe nxjerra e vendimit për regjistrim, plotësim apo refuzim të regjistrimit ➤ Azhurnimi tekstual i atributeve të pronës ➤ Dërgimi në shikim publik para aprovimit të ndryshimeve në RDPP 	Sektori i Kadastrit Sektori i Gjeodezisë

5. QËLLIMET

Duke marrë përbazë punët dhe aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, nevojat dhe çështjet që kanë lindur gjatë procesit të punës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, për vitin 2024 ka synim të arrijë këto qëllime:

1. Rritja e efikasitetit në punë, shqyrtimi i kërkesave sipas afatit ligjor, ruajtja dhe sistemimi i duhur i lëndëve dhe dokumentacioni;
2. Bashkëpunim me i mirë dhe i vazhdueshëm me organet lokale dhe qendrore me qëllim të shkëmbimit të përvojave më të mira të punës;
3. Fillimi i krijimit të një sistemi dhe procedure për të pasur evidenca të sakta në lidhje me menaxhimin e pronës së paluajtshme komunale;
4. Rritja e të hyrave si rezultat i vëllimit të punëve dhe shërbimeve;

5. Shqyrtimi i mundësisë që në bashkëpunim më instituconet vartëse të organizohen trajnime shtesë për stafin e kësaj drejtorie, duke ofruar shërbime sa më cilësore dhe në hap me kohën.

6. VËSHTIRËSITË DHE PENGESAT

Në punët e kësaj drejtorie si vështirësi në realizimin efikas të detyrave dhe përgjegjësive që janë paraqitur në këtë dokument paraqitet:

- Mungesa e dokumentacioneve për disa zona kadastrale;
- Fakti që nuk është bërë trashëgimia me kohë dhe pronat kanë mbetur të regjistruara në emër të personave tashmë të vdekur;
- Ndryshimet e pronarëve të cilët nuk janë zyrtarizuar;
- Mungesa e stafit të mjaftueshëm dhe profesional në shërbimin pronësoro-juridik për trajtimin e usurpimeve;
- Infrastruktura ligjore e pa reformuar në trajtimin e usurpimeve arbitrale të pronës komunale, etj.

Mbesim të përkushtuar në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive që na takojnë, duke qënë në nivel të detyrës dhe duke iu ofruar shërbime sa më të mira qytetarëve.

Komuna e Malishevës
Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
Drejtori: Bashkim Krasniqi

